



Komuna e Prishtinës  
R E N D D I T E :

Opština Priština -Municipality of Prishtina

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të punës për vitin 2018;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të veprimit për vitin 2019;
3. Miratimi i planit dinamik të punës për vitin 2019;
4. Informatë për çështje të sigurisë në Komunën e Prishtinës nga Policia e Kosovës;
5. Të ndryshme;

**Selim Pacolli** nënkyetar i Komunës e hapi mbledhjen duke i përshëndet të pranishmit dhe i njoftojë me rendin e ditës, si dhe njoftojë ardhjen e Zevendës Ministrinë e MPB Izmir Zeka dhe Destan Mustafa te cileve ua dha fjalën per diskutim.

**Izmir Zeka Zëvendës Ministër i MPB-së** falënderoje nënkyetarin për ftesën dhe i përgëzojë për punën e bërë në KKSBB. Pastaj i njoftoje të pranishmit përfshinë vedisuses që ka për qellim sensibilizimin e qytetareve lidhur me legalizimin e armëve të vogla dhe të gjuetisë për qytetarët e interesuar që ti mbajnë me leje përkatëse dhe afatin e aplikimit për tu pajisur me leje pë armë ku përfshinë periudhën 17 dhjetor deri me 10 qershor 2019. Sipas statistikave që kemi janë 250 mijë arme ilegale në nivel vendi dhe kjo shifër është e madhe dhe paraqet rrezik permanent për sigurinë e qytetarëve.

**Destan Mustafa** udhëheqës i divizonit për legalizimin e armeve i njoftojë me hapat që duhet marre për këtë proces ku përfshihen 7 sish ; të jetë 21 vjeçare të posedoje një armë gjuetie, pajiset me certifikata se nuk është nën hetime në stacionin policor, të lajmërohet në polici se posedon arme pa leje, pas 15 ditëve ta dërgojë armen ne kompaninë për licencim , në MBP pas 90 diteve merre pëlgimin që ka dorëzua armen të pajiset me certifikatë nga MMS , të pajiset me certifikatë për trajnimin e kryer në kompaninë përkatëse , Certifikatën shëndetësore QKUK. Pas këtyre procedurave pajiset me leje 5 vjeçare te mbajtjes se armës se gjuetisë me qellim gjuetie dhe të jetë anëtarë i shoqatës përkatëse , tha se jemi të hapur për pyetje.

**Lulzim Shehu** Bashkësia e Tarikateve të Kosovës tha ju na treguan rrugën se si të legalizohet arma por koston e pagesës nuk na treguat por ne bazë te asaj që dëgjuam po duket se është shtrenjtë.

**Hetem Kupina** e dëgjuam me vëmendje parafolësin dhe e përkrahi për diskutimin për koston e shtrenjtë , kjo iniciativa është e mirë ne do ti shpërndajmë neper BL të KKSBB broshurat e MBP-së dhe pyeti se sa kushton leje e përhershme për mbajtjen e armës.

**Izmir Zeka MPB** te ne hyjnë qarkullim 5 euro, ndërsa kostoja e përgjithshme përfshinë përfshin 400 euro sepse kompanitë private janë të pavarura nga ne , nese

Faqe 1 nga 7

blejmë e armë te re është 1000 euro , ne nuk kemi ndikim nëse dikush ka krye trajnimet ne shoqata private nga ky takim beje thirrje sepse i kemi prezent mediat tona qe te behet një sensibilizim me i madhe për kete qeshje sidomos përdorja e tyre ne ahengje ku shpesh ka pas viktima të pafajëshme .

**Lulzim Shehu** pas kësaj periudhe 5 vjeqare mund ta shes dikujt tjetër kështu që është e vështire të ndalohet.

**Destan Mustafa MPB-** informoje për çmimin e armëve te gjuetisë ku sillet pre 250-300 euro pastaj trajnimi dhe taksat tjera administrative .

**Selim Pacolli** rreziqet nga armet mund te vijnë më shumë nga fëmijët se sa nga të rriturit.

**Izmir Zeka** çdo qytetare i nënshtrohet ligjit dhe se pas këtij afati 5 vjeçare dënimet janë rigorozë deri 5 vjet burg për mbajtje të armës pa leje përkatëse .

**Selim Pacolli** i liroje përfaqësuesit e MPB-së për shkak te angazhime te tyre dhe e prezantoi rendin e ditës për mbledhje e pare te këtij viti.

Sa i përket pikës së parë për procesverbalin e mbledhjes së kaluar pasur vërejtje, por u miratua me dy vërejtje njëra nga **Lulzim Shehu** që emërtimi të jete Bashkësia e Tarikateve të Kosovës dhe tjetra nga **Belkize Cakollı** perfaqësuese e fesë Protestante e cila tha se gjithashtu e çmojë lartë patrullimin e policisë me rroba civile gjatë manifestimeve tona dhe kerkojë patrullime më të shpeshta në vendin ku ata mbajnë ritet fetare .

**Hetem Kupina-KLSP** Bardhosh tha se mbledhjet janë mbajtur të rregullta dhe te gjitha sa janë të parapara gjithsejtë 6(gjashtë) materialet dhe ftesat kanë ardhur me rregull në emalimet e anëtareve te KKSBB-së. Kërkojë që planet e veprimit duhet ta kenë bazën në planet strategjike . Ai mori si shembull se Drejtoria e Arsimit te raportojë dhunën në shkolla ,droga si dukuri e rezikshme mbajtja e shufrale etj. Pastaj DSHPSH te raportoje për ngritjen e çështjes së rrezikut nga qenët endacak çfarë është bere të implementohet në plan, plani strategjik të përpilohet ,pastaj Drejtoria e Inspeksioni te raportoje për ndalimin e kombibusëve ilegale qe operojnë ne Komunë ,njëherit e përgëzojë për punën Drejtore e ri Adonis Tahirin.

**Vesa Kelmendi**-Propozojë qe kërkesat te ja dërgojmë me emal z.Hateme sepse është e pamundur te përfshihen në procesverbali dhe ato të trajtohen dhe në mbledhjen e radhës të debatohet.

**Fatmir Bilalli -Kordinator i KKSBB-së** rapoti vjetor 2018 bazën e ka ne planin e veprimit ndërsa plani strategjik përfshihet pas mbledhjes , miratohet rapporti me vërejtët e dhëna , miratohen edhe pikat tjera duke i perfshirë vrejtjet dhe sygjerimet.

**Selim Pacolli** tha se pas çdo mbledhje kemi raportuar për punet e kryera dhe marrjen e masave per problemet e paraqitura varesisht mundesive tone që do të thotë nuk qendron ajo se nuk kemi punuar.

**Hetem Kupina** -tha se nuk theshte qe nuk eshte punuar por ajo duhet të qitet në leter planin strategjik çka është punuar e qfarë ka mbete pa u kryer dhe se qfarë afati do te kryhet .

**Isak Ejupi Komandant i stacionit të policisë së veriut** propozuje që të ndryshohet data e mbajtjes te jete para datës 15 qershor sepse kane aktivitete të shumta në polici e cila kerkese edhe u aprovua.

**Deli Avdiu** kryetarë i bashkesise lokale Nr-V tha se ne nuk kemi te themeluar KKSBB-në dhe asnjeher s'kam qenë i ftuar të marre pjesë nuk kam as materialin e mbledhjes.

## Informatë për çështje të sigurisë në Komunën e Prishtinës nga Policia e Kosovës;

**Shkëlzen Gjafa** komandat i stacionit policor qendra- tha se sa iperketn legalizimit të armëve ato që janë të trashiguar nga famijaret duhet vetem të kryejne procedura e legalizimit e jo te blehet në te zezën një të re e cila mund të kushtoj deri 1000 euro dhe te vine ne stacion policor për legalizim asesi nuk nenkupton per keto raste por vetem atë që ka lene trashigim ta legalizoj , perndryshe ne kemi një zyrtare policor per kete qellim dhe qe kryen procedurat e legalizimit. Ndërsa sa i perket statistikave kemi një rënje në per gjithësi të veprave të ndryshme si vepra penale 529 apo -32% apo 174 raste me pak se ne vitin paraprak ; grabitje nga 9 raste në 4 raste apo në -55% me pak; vjedhje të rënda prej 103 ka rene ne 45 raste apo -56%; raste të vjedhjeve nga 74 raste në 56 apo -12% : kemi pasur vjedhje të lehta 22 , 6 nga ato vetem rrugen "Fehmi Agani" kemi pasur vjedhje te lehta në qendër nëper lokale ku kemi identifikuar personin e cila eshte femer dhe 14 vjedhej te cilat i ka bërë. Dhunës në familje i kemi dhënë një prioritet për të vazhduar procedura në Gjykat nga 4 raste eshte ngrite në 12 raste sepse keto janë raste që jemi marrë me to dhe i kemi proceduar.Pastaj kemi planet operative si njesitin anti drogë, prishje e qetesës publike nga zhurmat e automjeteve dhe lokale te ne në oret e vona ku kemi shqiptuar 50 kundërvajtje dhe kemi krijuar një rregull dhe qetësi për qytetarët me masat e ndërmarra, te dielen kemi pasur disa thyrje të lokaleve monetare Bashkëpunojme me strktuar tjera çdo herë që kanë nevojë ose kerkojnë ndihmën e policisë.

**Isak Ejupi komandat i stacionit policor** -veriu pershendet gjithë të pranishmit dhe përgzoje këtë interesim shumë të madhe të pranishem në këtë mbledhje .Gjendja e sigurisë është jashtezakonisht e mirë dhe ka një renje cilësore të veprave të ndryshme penale falë zbatimit të planeve operative të policisë, kemi rënje tëveprave penale nga 195 në 150 raste ketu ka një kontribut të madhë wedisimi i qytetarëve për bashkepunin të ngusht me policinë . Dy keshilla lokale te sigurise kanë punuar intenzivisht ku rrisin gjendjen e sigurisë falë edhe angazhimit dhe realizimet e planeve operative për trafik , por taksite ilegale po ndikojnë në veshëtrsi më të mëdha në trafik si dhe ardhja e tyre nga qytete tjera . Inspeksioni të bashkepunojë me polici për linjat ilegale të veprojmë konform ligjit.

**Gani Berisha Komandant i stacionit policor -jugu** gjendja e sigurisë është e mirë, në pergjithësi ka rënje të veprave penale, por problem janë bërë veprat penale - grabitjet ku jemi deshmitare të disa rasteve. Vjedhje e rënda kanë një rënjie prej 50% falë angazhimit shtuar të të gjitha stacioneve poliore dhe njësive të polcisë me rroba civile kemi zbuluar raste dhe kemi parandaluar të tjerat . Sa i përket Sigurisë në trafik po kemi problem te rreti te flamuri te ish stacioni i polisë dhe propozjë të vendoset semafor.

**Besa Halimi-Krasniqi** përfaqësues e këshillit te prindërve në nivel komunal kërkoje që policia të raportoj përfushaten stop droga në shkolla, a ka rritje qfarë të bëjmë në nivel shteti duke bashkepunuar të gjithë në të mirë të femijeve tanë, qfarë masa të merren ndaj atyre që abuzojnë me të rinjet tanë me droga , masat që po merren nuk përmirësojnë gjendjen, si perjashtimi nga shkolla pastaj marrja në polici për moshën e tyre nuk mund te ndeshkohen apo te denohen, masat që merren mendojë se nuk ndikojnë në parandalim të kesaj dukuri e cila do të na shkatrrojë rininë tonë .

**Gani Berisha stacioni policor** Jugu tha se po kemi shumë raste të perdonuesve te droges duke filluar nga shkolla fillore pastaj në shkollat e mesme dhe si tha drejtori i arsimit mbledhjen e kaluar më shumë po ka raste më të shumta në shkollat me standarte më të lartë që famijet e tyre janë të perfshirë në droga , askush nuk ka mundësi të merret me femijë gjatë hyrjes apo daljes nga shkolla ne si polici kemi angazhime të shumta dhe të natyrave të ndryshme , diku 50 nxenës brenda ditës raportohen për drogë, pastaj paraqitja e pengesave të ndryshme për një kontrollë në shkolla qasja jo e duhur me institucionet shkolllore për ta kryer punën në nivel, duhet të kemi një njesi te veqante për shkolla , kapacitete që kemi nuk mund ta perfshijmë këtë fushë ashtu siç duhet.

**Selim Pacolli** mungesa e pedagogeve dhe psikologëve nëpër shkolla ndikon shumë në psikologjine e femijeve dhe se do të kishte efekte të mira në per gjithsi në rënje të rasteve me varësi në droga .

**Besa Halimi Krasniqi** njoftoj të pranishmit se nuk jemi aktive sa duhet përfemijet në per gjithesi duhet që edhe ne të marrim per gjegjsit tonë ndaj femijeve ne si këshill i prinderve ta japim më shume, sepse edhe në mbledhje te shkollat e mesme nuk vinë shumë prindër që të merren masa për tejkalim te këtyre dukurive negative .

**Isak Ejupi komandat i stacionit policor** -veriut në aspekt operativ kemi renje të masave ndaj drogave pastaj kemi edhe mbajtje te armeve në shkolla e cila dukuri ështe shumë shqetesuese , prandaj duhet të gjitha hallkat e pushtetit të jenë më aktive bashkepunimi me policinë dhe forumet tjera të sigurisë.

**Shkëlzen Gjafa komandat i stacionit policor qendra** tha se duhet te jemi në bashkepunim me Drejtorinë e arsimit ,prindërit dhe mesimëdhensit policia e lagjes prinderit dhe kujdestaret te organizojme trajnime me njohes të kesaj dukurie te dihen simptomet sjelljet që tregojnë varëshmëri me substanca narkotike, patrollimi i polcisë në afersi të shkollave , tri raste të lajemeruarë në polici që nuk shkojnë në shkollë , të njoftohet Drejtoria e Arsimit ,Keshilli i prinderve pastaj perfaquesuesit fetar si hoxha prifti secili nga kendi i vet të jap kontributin e duhur .

**Idriz Xhigilli** perfaquesues i fesë islame permendi rastet te Shkolla "Sami Frashëri prinderit u jepin para në shkolle neglizhenca e prindit po reflektohet ndryshimi i sjelljes së femijeve tane psh në mbledhej të prindërvë vinë një numër shumë i vogël pa interesim përfemijë.

**Besa Halimi Krasniqi** perfaquesuese e keshillit të prindërvë tha se ështe më mirë te merremi me rastin mos të fshihet rasti por te merren masa parandaluese , sanksionimi edhe ndaj prindit të jetë obligativ pastaj edhe femijet të ju permbahen Rregulloreve të shkollës të kete liri të shprehjes.

**Safet Kamberi KLSB Dardani** tha se një rol kyq e kanë edhe keshilli i prindërvë për përmiresimin e gjendjes së sigurisë në shkollë gjithashtu edhe udhëheqesit duhet ta kenë per gjegjsinë përfmiresim te sigurisë në shkolla i cili mendoje se është jo profesionist dhe gjendja është alarmante ku ka mbi 1000 nxenes stafi duhet të jetë ne kryerje të detyrave të tyre sepse eshte ne gjendje te keqë siguria ,policia është shumë efikase dhe bashkepunon në kryerje të detyrave . Komuna nuk ka reflektuar pozitiv eshte bërë anulimi i 20 konkurseve nuk jane zbatuar vendimet e gjykates lidhur me stafin e shkollës .

## Të Ndryshme

**Safet Kamberi KLSB-Dardani** venja e kamerave edhe ne disa vende kishte me qenë mirë të percillet gjendja e siguri , po kemi problem me qenet endacak nuk ka ndriqim të mjaftueshem pastaj problem me kanalizim në afersi të shkolles është gjendje alarmante kjo lagje ka mbi 65 mijë banorë , te shkolla "7 Marsi" në emshir ka shumë problem me rrjedhejn e ujërave të zeza te kolektori .

**Selim Pacolli nënkyetar i Komunës** tha se i perket pranimit të drejtoreve të shkollave se vin nga lagja Nic nga është edhe kryetari është gjykimi i pa drejtë dhe jo etike . Sa i përket pranimit te drejtoreve eshte bere nga një komision e pavarur dhe profesional dhe se nuk i ipet e drejta askujt te flitet ne emer te dikujt.

**Besa Halimi Krasniqi** perfaqesuese e keshillit të prindërve tha se e kemi monitoruar perzgjedhjen e drejtoreve dhe e vlerojë shumë për zgjidhje të drejtë dhe gjithë perfshirëse.

**Ilmi Uka perfaqesues i KLSB Keqekollë** i pershendetë të gjithë të pranishmit tha se ky regjomi perfshin tetë fshatra te malesise se Gollakut dhe e paraqiti kerkesen e qytetareve te asaj ane lidhur me transportin publik, ku kane paralajmeruar protestua te dheu i kuq në kufi kekoje nga policia t'i mirëkuptoje ata pasi kane kerksen shumë te arsyeshme .

**Shkëlzen Gjafa komandat i stacionit policor-** tha se 72 orë para protestes duhet të lajmerohet policia .

**Deli Avdiu kryetar i BL-së nr 5** në Veterik i pershendetë gjithë te pranishmit ju njoftoje se qe nga viti 2002 mbi 500 kerkesa i kemi bere ne Drejtorite e ndryshme edhe stacionit policor -Jugu per ndihme por kanë qenë vetem premtimi gojore ku nga ata kemi kerkuar një automjet të policisë te jete atje sepse po ka aksidente me fatalitetë të mëdha t'i leshojne dritat .KLSB nuk ka te zgjedhur .Sa i perket planit strategik te formohet një komision dhe ti klasifikoje kerkest sipas prioriteteve për zgjidhjen e tyre .

**Dejan Millutinoviq** tha se para dy dite ka pas zjarre dhe disa herë kemi kerkuar nga "KUR" Prishtina sanimin e gjendjes ku në 5 vende rrjedhin gypat e ujit .

**Sevdije Ramadani** u prezantu si perfaqesuese e komunitetit goran si anetare e re në KKSBB .

**Heten Kupina KLSB Bardhosh** ku perfshihen keto fshatra: Bardhosh, Besi, Prugvc dhe Barilevë identifikojë shkakëtaret e cenimit të sigurisë:

**DSHPMSH** - mungesa e shenjave në rrugë ; vendosja e shenjave të trafikut në rrugë afersi te shkollave; hedhja embeturinave vend e pa vend ; qenet endacak;mungesa e transportit për qytetarë; transportimi nga te palicencuarit; nevoja per autobus te Trafikut Urban per fshatratë Trudë dhe Bernicë e poshtme ; nriqimi i rrugeve ;vendosja e nje kontejneri per mbetyrina te stacioni i autobusëve .

**Drejtorinë e Arsimit:** parandalimi i drogave; parandalimi i mbajtjes së mjeteve të rrezikëshme (shufer, thika ,boks , arme zjarri etj); te ndalohet bartja e telefonave gjatë mesimit;te organizohen ligjerat perlluftimin e ketyre dukurive;te parandalohet qendrimi i të pa puneve në shkollë dhe oborr te saj;bartja e nxenesve me automjete të palicencuara dhe të tej ngarkuara;vendosja dhe meremetimi i rrrethojave në shkollë; mungesa e ujit të mjaftueshem në shkollë( rrezik nga kundërmimet).

**Drejtori e Shëndetësisë:** sfide e madhe mungesa e një AMF per mbi 20 000 banorë nuk i ploteson kushtet me staf dhe hapsirë dhe kerkesa te medha per sherbime mjekesore ; kerkese per punë me ndrrime si dhe te kete kujdestari gjate vikendit ose të kaloje AMF-QMF pasi qe numri i pacienteve eshte 300-400%.

**Drejtoria e Inspektionit:** të parandalohet transporti ilegal i qytetreve ; të parandalohen shitesit ordiner pranë ;te ndalohet therrja e kafshëve dhe shpezeve pranë rrugëve; te ndalohet prerja ilegale e pyjeve.

**Violeta Hasni KLSB Qendra** tha pas disa takimeve që kemi realizuar me nënkyryetarin z.Muhedin Nushi ,Komandantin e stacionit policor z. Shkelzen Gjafa disa banore dhe grupin Gastronom është stabilizuar gjendje e zhurmës në shumicën e bizneseve kafitereve. Por kemi disa kafiteri të cilat prishin rendin dhe qetësin në lagje janë të njohura për Komunën -Policinë. Falenderojmë Policinë-Komunën për bashkepunim të mirë qe kanë me KLSP-Qendra, thotë se është një kërkesë nga banoret e lagjes për parking në rrugën "Nuri Zeka " shpresojënë një të ardhëme të afërt të zgjedhet problemi i ketyre kafiterive të pakta që po pengojnë banorët të jetojnë jetën normale në shtepit e tyre.... .

**Selim Pacolli nenkyrytar i Komunës** sa i perket problemit të zhurmës kemi diskutuar dhe eshte permiresuar gjendja pokemi probleme me nenkalimet te cilat nuk kane qenë funksionale , pastaj i dha fjalën nje personi që shumë ka bërë per çeshtjen e sigurisë edhe njothes i shkëlqyer i fushës së sigurisë

**Arbër Beka** udhheqes i Inpektoriatit policor i divizonit dhe mardhenje me publikun pershendetë të pranishmit dhe i pergezoje per takimet e mbajtura me forumet e sigurisë duke filluar nga policia pastaj KLSB si dhe EVSB ideja eshte qe ti inkurajoje forumet e sigurisë si dhe qytetaret qe nese kane ndonje annkese lidhur me sherbimet e ofruara nga policia të shprehen lirisht , apo ndonjë kerkese specifike siq ishte ajo prej përfaqësuesit të Lagjes Veternik për hapjen e një nënstacioni policor apo formimin e KLSP-së ku do te jemi ne kontakt të përhershëm me kordinatorin e KKSB-së Fatmir Bilallin por edhe sfida që na dalin do të na ndihmojnë të përfeksjonohemi më mirë.

**Procesmbajtësja**

**Hateme Gashi**

**Kryesuesi i Mbledhjes KKSB-së**

**Shpend Ahmeti**

